URDHËR
Nr. 164, datë 21.10.2025

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI ASPEKTE TË CAKTUARA TË KUSHTEVE TË PUNËS SË PUNONJËSVE TË LËVIZSHËM TË ANGAZHUAR NË SHËRBIME NDËRVEPRUESE NDËRKUFITARE NË SEKTORIN HEKURUDHOR"[1]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 16, të ligjit nr. 142/2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", nenit 70, të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare'",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Mbi aspekte të caktuara të kushteve të punës së punonjësve të lëvizshëm të angazhuar në shërbime ndërvepruese ndërkufitare në sektorin hekurudhor", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Autoriteti Rregullator Hekurudhor, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, sipërmarrjet hekurudhore, administruesit e infrastrukturës hekurudhore dhe subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVËNDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
MBI ASPEKTE TË CAKTUARA TË KUSHTEVE TË PUNËS SË PUNONJËSVE TË LËVIZSHËM TË ANGAZHUAR NË SHËRBIME NDËRVEPRUESE NDËRKUFITARE NË SEKTORIN HEKURUDHOR

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është zbatimi i Marrëveshjes së lidhur më 27 janar 2004, midis Komunitetit të Hekurudhave Evropiane (CER) dhe Federatës Evropiane të Personelit të Transportit (ETF), mbi aspekte të caktuara të kushteve të punës së punonjësve të lëvizshëm të angazhuar në shërbime ndërvepruese ndërkufitare të transportit hekurudhor ndërkombëtar. Teksti i marrëveshjes është bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

Neni 2
Mbrojtja e punonjësve hekurudhorë

1. Sektori hekurudhor shqiptar mban ose aplikon dispozita më të favorshme se ato të përcaktuara nga kjo rregullore, në rast se kapacitetet institucionale udhëhiqen nga procedurat e brendshme. Këto dispozita rregullatore mbështeten kur lëshohen urdhrat administrativë mbi

[1] *Kjo rregullore përafron plotësisht me:*
32005L0047, Direktivën e Këshillit 2005/47/KE, të 18 korrikut 2005, mbi Marrëveshjen midis Komunitetit të Hekurudhave Evropiane (CER) dhe Federatës Evropiane të Punëtorëve të Transportit (ETF) mbi aspekte të caktuara të kushteve të punës së punëtorëve të lëvizshëm të angazhuar në shërbime ndërvepruese ndërkufitare në sektorin hekurudhor.

autorizimet për punonjësit e lëvizshëm të angazhuar në shërbime të kalimeve kufitare dhe në dispozicion të tyre.

2. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje, në asnjë rrethanë, nuk përbën bazë të mjaftueshme për të justifikuar një ulje të nivelit të përgjithshëm të mbrojtjes së punonjësve në fushat e mbuluara nga kjo rregullore. Kjo nuk cenon të drejtat e sipërmarrjeve hekurudhore, subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe administruesve të infrastrukturës hekurudhore për të përcaktuar, në sferën e rrethanave të ndryshme, rregullime legjislative ose kontraktuale nga ato, që mbizotërojnë në kohën e miratimit të kësaj rregulloreje, me kusht që gjithmonë të përmbushen, kërkesat minimale të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 3
Raportimi

Pa cenuar dispozitat e marrëveshjes, sipërmarrjet hekurudhore, administruesit e infrastrukturës hekurudhore dhe subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen, pas konsultimit me shërbimet e menaxhimit dhe të punës në nivel kombëtar, rajonal dhe Evropian, raportojnë te ministri përgjegjës për transportin, në vijim ministri. Nëse një vlerësim i mëtejshëm konsiderohet i nevojshëm, mund të kërkohet çdo informacion mbi zbatimin e kësaj rregulloreje, në kontekstin e zhvillimit të sektorit hekurudhor.

Neni 4
Kundërvajtjet administrative

Legjislacioni në fuqi për marrëdhëniet e punës përcakton se cilat ndështkime zbatohen kur shkelen dispozitat kombëtare dhe dispozitat e miratuara në përputhje me këtë rregullore dhe institucionet përgjegjëse marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që ato të zbatohen.

Neni 5
Dispozitat kalimtare

Sipërmarrjet hekurudhore, administruesit e infrastrukturës dhe subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen, marrin të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të garantojnë zbatimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë të dispozitave të përcaktuara nga kjo rregullore dhe informojnë ministrin.

MARRËVESHJE
E LIDHUR NGA FEDERATA EVROPIANE E PUNËTORËVE TË TRANSPORTIT (ETF) DHE KOMUNITETI I HEKURUDHAVE EVROPIANE (CER) MBI ASPEKTE TË CAKTUARA TË KUSHTEVE TË PUNËS SË PUNONJËSVE TË LËVIZSHËM HEKURUDHORË TË ANGAZHUAR NË SHËRBIME NDËRKUFITARE

Neni 1
Fushëveprimi

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për punonjësit e lëvizshëm hekurudhorë të caktuar për shërbime të ndërveprimit të kalimeve ndërkufitare hekurudhore, të kryera nga sipërmarrjet hekurudhore.

2. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje është opsionale për trafikun ndërkufitar të udhëtarëve lokalë dhe rajonalë, trafikun ndërkufitar të mallrave që udhëton jo më larg se 15 kilometra përtej kufirit dhe për trafikun midis stacioneve zyrtare kufitare të listuara në aneks.

3. Është, gjithashtu, opsionale për trenat në itinerare ndërkufitare, të cilët nisen dhe ndalojnë në infrastrukturën e të njëjtit vend dhe përdorin infrastrukturën e një vendi tjetër, pa u ndalur atje (dhe të cilët për këtë arsye mund të konsiderohen operacione transporti kombëtar).

4. Lidhur me punonjësit e lëvizshëm të angazhuar në shërbime ndërkufitare ndërvepruese, kjo rregullore nuk zbatohet për ato aspekte për të cilat kjo Marrëveshje përmban dispozita më specifike.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "Shërbime të ndërveprimit të kalimeve ndërkufitare" nënkupton shërbimet e kalimeve kufitare hekurudhore për të cilat kërkohen, nga sipërmarrjet hekurudhore, certifikatat e sigurisë hekurudhore, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi;
2. "Punonjës hekurudhor i lëvizshëm i angazhuar në shërbime të ndërveprimit të kalimeve kufitare" nënkupton çdo punonjës që është anëtar i një personeli hekurudhor të trenit, i cili është caktuar në shërbime të kalimeve kufitare të ndërveprimit për më shumë se një orë në bazë të turnit ditor;
3. "Kohë pune" nënkupton çdo periudhë gjatë së cilës punonjësi është në punë, në dispozicion të punëdhënësit dhe kryen aktivitetet ose detyrat e caktuara, në përputhje me ligjet dhe praktikën kombëtare;
4. "Periudhë pushimi" nënkupton çdo periudhë që nuk është kohë pune;
5. "Kohë nate" nënkupton çdo periudhë, jo më pak se shtatë orë, siç përcaktohet nga legjislacioni kombëtar, dhe që duhet të përfshijë në çdo rast periudhën midis mesnatës dhe orës 5 të mëngjesit;
6. "Turn nate" nënkupton çdo turn prej të paktën tre orësh pune gjatë kohës së natës;
7. "Pushim larg shtëpisë" nënkupton pushimin ditor që nuk mund të merret në vendin e zakonshëm të banimit të punonjësit hekurudhore të lëvizshëm;
8. "Drejtues treni (makinist)" nënkupton çdo punonjës përgjegjës për operimin e një njësie tërheqëse të trenave (lokomotivës) që përmbush kushtet e nenit 5, pika 15, të ligjit nr. 142/2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë";
9. "Koha e drejtimit" nënkupton kohëzgjatjen e aktivitetit të planifikuar, ku drejtuesi i trenit është përgjegjës për njësinë tërheqëse të trenave, duke përjashtuar kohën e planifikuar për të përgatitur (bërë gati për nisje) ose për ta fikur atë njësi tërheqëse të trenit, por duke përfshirë çdo ndërprerje të planifikuar kur drejtuesi i trenit mbetet përgjegjës për njësinë tërheqëse të trenit.

Neni 3
Pushimi ditor në shtëpi

1. Pushimi ditor në shtëpi duhet të jetë minimum 12 orë rresht për periudhë 24-orëshe.
2. Megjithatë, mund të reduktohet në minimumin nëntë orë një herë në çdo periudhë shtatëditore. Në këtë rast, orët që korrespondojnë me diferencën midis pushimit të reduktuar dhe 12 orëve do t'i shtohen pushimit ditor të ardhshëm në shtëpi.
3. Një pushim ditor i reduktuar dukshëm nuk do të caktohet midis 2 (dy) pushimeve ditore larg shtëpisë.

Neni 4
Pushimi ditor larg shtëpisë

1. Pushimi minimal ditor larg shtëpisë duhet të jetë tetë orë rresht për periudhë 24-orëshe.
2. Një pushim ditor larg shtëpisë duhet të pasohet nga një pushim ditor në shtëpi.
3. Rekomandohet që t'i kushtohet vëmendje nivelit të rehatisë së akomodimit të ofruar për personelin hekurudhor që pushon larg shtëpisë.

Neni 5
Pushimet

a) Makinistët:

1. Nëse koha e punës së një makinisti është më e gjatë se tetë orë, duhet të merret një pushim prej të paktën 45 minutash gjatë ditës së punës, ose, kur koha e punës është midis gjashtë dhe tetë orësh, ky pushim duhet të jetë të paktën 30 minuta i gjatë dhe duhet të merret gjatë ditës së punës.

2. Ora e ditës dhe kohëzgjatja e pushimit duhet të jenë të mjaftueshme për të siguruar një pushim efektiv të personelit.

3. Pushimet mund të përshtaten gjatë ditës së punës në rast vonesash të trenit.

4. Një pjesë e pushimit duhet të jepet midis orës së tretë dhe të gjashtë të punës.

5. Neni 5(a) nuk zbatohet nëse ka një makinist të dytë. Në këtë rast, kushtet për dhënien e pushimeve duhet të rregullohen në nivel në shkallë kombëtare.

b) Personeli tjetër në bordin e trenit:

Për stafin tjetër në bord, duhet të merret një pushim prej të paktën 30 minutash nëse koha e punës është më e gjatë se gjashtë orë.

Neni 6
Periudha e pushimit javor

1. Çdo punonjës i lëvizshëm i angazhuar në shërbime të ndërveprimit të kalimeve kufitare hekurudhore ka të drejtë, për një periudhë shtatëditore, për një periudhë minimale pushimi javor të pandërprerë prej 24 orësh plus 12 orë pushim ditor të përmendur në nenin 3, si më sipër.

2. Çdo vit, çdo punonjës i lëvizshëm duhet të ketë 104 periudha pushimi prej 24 orësh, duke përfshirë periudhat 24-orëshe të 52 periudhave javore të pushimit, duke përfshirë: 12 periudha pushimi të dyfishta (prej 48 orësh plus një pushim ditor prej 12 orësh), duke përfshirë të shtunën dhe të dielën, dhe 12 periudha pushimi të dyfishta (prej 48 orësh plus një pushim ditor prej 12 orësh) pa garancinë se kjo do të përfshijë një të shtunë ose të diel.

Neni 7
Koha e drejtimit

1. Koha e drejtimit, siç përcaktohet në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje, nuk duhet të kalojë nëntë orë për një turn ditor dhe tetë orë për një turn nate, midis dy periudhave të pushimit ditor.

2. Koha maksimale e drejtimit gjatë një periudhe dyjavore është e kufizuar në 80 orë.

Neni 8
Kontrollet

Sipërmarrjet hekurudhore duhet të mbajnë një regjistër të orëve të punës ditore dhe periudhave të pushimit për punonjësit e lëvizshëm për të lejuar monitorimin e pajtueshmërisë me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Regjistri përmban informacionin mbi orët aktuale të punës dhe duhet të jetë i disponueshëm nga sipërmarrjet hekurudhore për të paktën një vit.

Neni 9
Mbrojtja e punonjësve

Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të përbëjë në asnjë rast bazë të vlefshme për uljen e nivelit të përgjithshëm të mbrojtjes së ofruar punonjësve të lëvizshëm, të angazhuar në shërbime të ndërveprimit të kalimeve ndërkufitare hekurudhore.

Neni 10
Ndjekja e Marrëveshjes

Ndjekja e zbatimit dhe e aplikimit të kësaj Marrëveshjeje nga sipërmarrjet hekurudhore, administruesit e infrastrukturës dhe subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen bëhet nga organet kompetente sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 11
Vlerësimi

Vlerësimi i kësaj Marrëveshjeje bëhet sipas ecurisë të zhvillimit të transportit ndërveprues ndërkufitar në përputhje me legjislacionin e punës në fuqi.

Neni 12
Rishikimi

Dispozitat e kësaj mësipërme rishikohen sipas sugjerimeve të organeve përgjegjëse për zbatimin dhe për kontrollin e zbatimit sipas përshkrimit të mësipërm.

ANEKSI
LISTA E STACIONEVE ZYRTARE KUFITARE TË VENDOSURA PËRTEJ KUFIRIT PREJ 15 KM DHE PËR TË CILAT MARRËVESHJA ËSHTË OPSIONALE

RZEPIN (PL); TUPLICE (PL); ZEBZYDOWICE (PL); DOMODOSSOLA (IT)